



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	127 / 13
Nr. i fq. / Br. st	- 11 -
Data: / Datum	30. 05. 2013
VUSHTRRI - VUČITRN	

**REPUBLIKA E KOSOVËS****KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI****P R O C E S V E R B A L**

**Nga mbledhja e IV-të për vitin 2013, e Kuvendit Komunal në
Vushtrri, mbajtur më 25.04.2013**

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën 10:10. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Avdullah Halimi, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Gani Imeri, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gérxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muhamrem Shabani, Nysret Gérxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrovë, Syzana Syla, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Xhemajl Pllana dhe Zeqir Hasani.

Munguan: Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ferit Idrizi, Naile Osmani, Vlora Qirezi, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe drejtoret e drejtive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Debat lidhur me rendin e ditës:

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se ka bërë një kërkesë në mbledhjen e KK-së, të muajit shkurt për t'u informuar për pagesën e tatimit në pronë për çdo fshat në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2012 dhe e ka marrë përgjigjen me 20 mars se nuk është përgatitur ende, dhe as në këtë mbledhje nuk e ka marrë. Pastaj tha se në vitin e kaluar ka kërkuar informatë për dy rrugë për fshatrat Bukosh dhe Tërllobuq, pasi që e ka dorëzuar materialin (nënkryetarit të komunës) sesi kanë qenë të dëmtuara, ku ka pyetur se çka është ndërmarrë për ato rrugë, të cilat kanë qenë shumë afër për të kaluar periudha një vjeçare e 10 %-shit për garacionin bankar për t'u ndërmarrë diçka për përmirësimin e atyre rrugëve, por pasi që nuk ka marrë asnjë përgjigje, përsëri kërkoi informatë (për mbledhjen e ardhshme të KK-së) për dy kërkesat në fjalë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- pyeti kryesuesin e kuvendit pse kuvendi i komunës nuk i përbahet planit të punës së kuvendit, pasi që për muajin mars ka qenë e paraparë një Informatë lidhur me parandalimin e ndërtimeve të egra, por një

informatë e tillë nuk është paraqitur fare, prandaj kërkoi përgjigje pse ka munguar informata e tillë. Pastaj propozoi që në këtë mbledhje të KK-së ose në mbledhjen tjetër të KK-së të futet në rend dite Informata lidhur me rrjedhën e të mbjellave pranverore. Në vazhdim tha se pasi që nuk po zbatohet marrëveshja e arritur në mes shefave të grupeve kuvendare, Grupi kuvendar i AAK-së nuk paraqet propozim lidhur me pikën nr. 8 të rendit të ditës, pasi që komisionet po bëhen të njëanshme dhe njëpartiake, duke shtuar se edhe për pikën nr. 9 janë bërë dy propozime nga i njëjtë anëtar i kuvendit.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- për pikën në “të ndryshme” kërkoi një informatë lidhur me një ngjarje pozitive në komunën tonë, pasi që këto ditë po qëndrojnë në Vushtrri disa afaristë: një japonez, jugkorean dhe një shqiptar dhe në bazë të informatave të tij këta afaristë janë të interesuar për ndërtimin e fabrikës përpunimin e kërpudhave, ku pritet të ndodhin rreth 100 milionë investime dhe 300 të punësuar, prandaj është e nevojshme që të informohen anëtarët e kuvendit për çështjen në fjalë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- sqaroi se Ligji për Ndërmarrjet Publike thotë që komuna është e obliguar që të formojë bordin prej tre anëtarëve, njëri anëtar duhet të jetë nga qeveria komunale, kurse dy anëtarët tjerë nga kuvendi i komunës, me ç'rast shtoi se formimi i komisionit nuk është votuar njëanshëm dhe nuk ka qenë njëpartiak, sepse në komision është një anëtar nga PDK-ja dhe një nga PD-ja.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se edhe në nivelin qendror, në çdo vendim dhe në çdo bord shprehet përbërja e kuvendit, prandaj edhe në rastin konkret është dashtë të veprohet sipas proporcionit të votave të subjekteve politike në kuvendin e komunës, dhe shtoi se në atë rast është bërë mbivotim.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se nuk është duke u respektuar Rregullorja e re e Kuvendit të Komunës, pasi që anëtarët e kuvendit obligohen që në rastin e pjesëmarrjes në mbledhjet e kuvendit, të bartin kartelat identifikuase duke i mbajtur në vende të dukshme, dhe shtoi se kryesuesi i kuvendit në ditën e parë pas aprovimit të rregullores së re, po e shkel rregulloren dhe po i prin shkeljes së rregullores. Pastaj përmendi çështjen e lirimit të bizneseve nga taksa komunale, dhe në veçanti përmendi punimet që janë duke u zhvilluar në rr. “Dëshmorët e Kombit” ku paraqiti vërejtje pasi që nuk ka asnjë tabelë lajmëruese se kur kanë filluar punimet dhe kur parashikohet të përfundojnë, duke shtuar se një tabelë e tillë do t'i kontribuonte transparencës.

Sabri Ferati, anëtar i kuvendit- propozoi që të hyjë në rend dite formimi i komisionit përvlerësimin e gjendjes, si dhe ndërmarrjen e masave të menjëherëshme, pasi që gjendja e familjes së invalidit të luftës së UÇK-së (Isa Murati) është e mjerueshme. Mandej propozoi që të hyjë në rend dite një informatë se çfarë është bërë për ndërtimin e banesave të dëshmorëve, invalidëve dhe skamnorët për të cilët janë ndarë trojet.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- tha se bashkëshortja e ish të burgosurit (Zenun Gjocaj) i cili ka vdekur para disa muajsh, ka mbetur në një gjendje të keqe të banimit, prandaj ky veprimtar e meriton që komuna të bëjë një përkujdesje lidhur me çështjen e banimit përbashkëshorten e tij.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- sqaroi se Rregullorja e re për Punën e Kuvendit është duke u punuar dhe anëtarët e kuvendit do të pajisen me të në mbledhjen e ardhshme të KK-së.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Shërbime Komunale (shqyrtimi i parë).
3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme (shqyrtimi i parë).
4. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: janar-mars 2013.
5. Shqyrtimi i Draft-strategjisë për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve (shqyrtimi i dytë).
6. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Transparencë (shqyrtimi i dytë).
7. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Dhëni e Dekoratave (shqyrtimi i parë).
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit vlerësues për dhëni në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit mbi lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për Komitetin për Auditim.
11. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për injekim për Liberta Ahmetin.
12. Shqyrtimi i kërkesës së shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së për ndarjen e mjeteve për sigurimin fizik të objektit-zyrave të tyre.
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës.
14. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se në faqen 10 të procesverbalit është e nevojshme të shënohet se pas shqyrtimit të pikës nr. 9 të rendit të ditës, mori këtë numër të votave për shkak të majorizimit të përgjithshëm dhe të paligjshëm, dhe për këtë arsyesh Grupi kuvendar i AAK-së e lëshoi mbledhjen e KK-së. Po ashtu duhet të cekën arsyet pse është ndërprerë mbledhja e KK-së.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- në faqen nr. 13 propozoi që diskutimit të tij t'i shtohet edhe kjo fjalë: “është për keqardhje që këto dy institucione të larta nuk arrijnë marrëveshje për interes të përbashkët, kurse na po bisedojmë me Serbinë për të bërë marrëveshje (edhe pse na kanë vrarë dhe na kanë grirë)”.

Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, me vërejtjet dhe sugjerimet e M. Shabanit dhe B. Jasharit.

2. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Shërbime Komunale (shqyrtimi i parë).

Sami Istrefi, drejtor i DSHP-së- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto vërejtje dhe propozime: me një nen apo aline të veçantë të rregullohet çështja e mirëmbajtjes së urave; te neni 97.2, propozoi t'i shtohet një aline që flet për mbrojtjen e tabelave, pasi që tabelat po dëmtohen dhe po shkatërrohen; te neni 120 propozoi që të futen edhe shkollat dhe oborret e tyre; te neni 163, propozoi që në

vend të fjalisë "shtrati i lomit" të thuhet "shtrati i lumenjve". Në fund kërkoj që rregulloret që aprovojen në kuvendin e komunës të jetësohen.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së, tha se vërejtjet tona kryesore kanë të bëjnë me ujësjellësin dhe kanalizimin duke shtuar se një çështje e pazgjidhur është se ku përfundon rrjeti i ujësjellësit, te nyja e parë apo pas ujëmatësit, si dhe pyeti se ujëmatësi a është pronë e qytetarit apo është e kompanisë publike, me ç'rast shtoi se në bazë të përvojës së deritashme është kuptuar se ujëmatësit janë pronë e kompanisë, dhe pjesa më e madhe e ujëmatësve janë pronë e kompanisë, prandaj edhe pjesa tjetër duhet të jetë obligim i kompanisë për të instaluar ujëmatësin, dhe në rast të dëmtimit të tij, pronari duhet ta lajmërojë kompaninë për riparimin apo ndërrimin e tij. Në vazhdim propozoi ndryshime dhe plotësimë për këto nene: te neni 8.3, tha se duhet t'i shtohet fjalia "si dhe t'i furnizojë qytetarët me ujë përmes cisternave"; te neni 11.3 propozoi t'i shtohet fjalia "deri tek nyja tjetër, kur e kalon ujëmatësin"; te neni 18, tha se duhet të eliminohen pagesat paushalle, dhe kompania duhet të vendosë ujëmatësit, në mënyrë që të mos lihet hapësirë për pagesa paushalle; neni 20, tha se përbajtja e këtij neni është çështje diskutabile; te neni 28.1 "b" fjalë "paraqet" të zëvendësohet me fjalën "paguan"; te neni 31.3, tha se inspeksioni duhet t'i ndihmojë, por kjo çështje është ekskluzivisht e ndërmarrjes; te neni 35 kërkoj që të precizohet një afat i arsyeshëm; te neni 61.3, tha se ndoshta do të ishte më mirë sikur të thuhej pa lejen e urbanizmit, në vend të DSHP-së, duke shtuar se edhe te nenet 67 dhe 68 kërcohët leje vetëm nga DSHP-ja; te neni 163.2, tha se në këtë kohë ndërmarrja nuk ka mundësi të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit, prandaj propozoi të riformulohet që ky nen të vlejë prej që të fillon funksionimi i fabrikës së re të ujit.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- e falënderoi USAID-in për përkrahjen që po e jep edhe në këtë çështje, pasi që ka bërë një analizë shumë të mirë lidhur me performancën e shërbimeve në Komunën e Vushtrrisë, sepse kjo është një ndihmesë shumë e madhe për drejtorinë komunale për të kuptuar se ku janë defektet.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanim vendosi me sa vijon:

**Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Shërbime Komunale.
Diskutimi publik fillon nga data 26.04.2013 dhe zgjatë deri më 20.05.2013.**

3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme (shqyrtimi i parë).

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto vërejtje dhe propozime: te neni 1, duhet të shtohet edhe kjo fjalë: "për nxënës të shkollave të mesme të Komunës së Vushtrrisë të sistemit publik"; te neni 2.1, duhet të përfshihen edhe nxënësit.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto vërejtje dhe propozime: alineja 1 e nenit 9 propozoi që të kalohet në nenin 5 dhe të jetë alineja 5.4; kurse neni 13.4 është në kundërshtim me nenin 14.4.

Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, propozoi që të caktohet numri i bursave dhe shuma e mjeteve që iu ndahen studentëve.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se që në fillim të draft-rregullores duhet të shtohet edhe nociioni <nxënës talent>, pasi që ka nxënës në shkollat e mesme të larta që meritojnë të ndihmohen. Po ashtu propozoi që të plotësohet neni 3, pasi që ky nen ju jep mundësi vetëm studentëve të drejtimeve deficitare, dhe shtoi se ky nen është i mangët, pasi që duhet t'ju jep mundësi për marrje të bursave edhe studentëve të drejtimeve tjera, prandaj propozoi që ky nen të korrigohet. Te neni 9 propozoi që të

shtohet edhe kategoria e nxënësve talent të shkollave të larta; te neni 10 "d" propozoi këtë riformulim: "profilet deficitare të kenë përparësi".

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- pyeti se këto ditë a ka punuar komisioni për ndarjen e bursave, pasi që të interesuarit për bursa kanë shkuar nëpër zyra, por iu është thënë që bursat janë ndarë, prandaj pyeti çfarë kuptimi ka debati për draft-rregullore, pasi që këto ditë janë ndarë bursat. Pastaj lidhur me draft-rregulloren në fjalë tha se te neni 7.1 propozoi që të thuhet "bursë komunale"; te neni 8 nën "e", tha se nota mesatare është shumë e lartë, prandaj propozoi që të hiqet. Në vazhdim duke iu referuar kuadrove deficitare, tha se më nuk ka kuadro deficitare, kurse te neni 9.3 mungon kategoria e dëshmorëve të luftës; te neni 13.4, propozoi t'i shtohet fjalia: "duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më lartë".

Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit- duke iu referuar propozimit që në nenin 2 të kësaj draft-rregulloreje të shtohen edhe nxënësit, tha se gjatë hartimit të këtij drafti, komisioni ka ardhur në përfundimin se kriteret për nxënës dhe kriteret për studentë nuk mund të janë të njëjtë, prandaj komisioni ka propozuar që të hartojet një rregullore tjetër enkas për nxënës, kurse shuma e lartësisë së bursës caktohet në konkurs.

Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit- në cilësinë e anëtares së komisionit, tha se në këtë vit numri i të interesuarve për bursa është shumë i madh, dhe shtoi se bursat akoma nuk janë ndarë.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore- tha se nëse draft-rregullorja në fjalë nuk vlen për nxënës, atëherë duhet të hiqet termi "nxënës". Kurse duke iu referuar nenit 2, tha se kuvendi i komunës nuk ndan bursa, prandaj propozoi këtë riformulim: "kuvendi i komunës me vendim çdo vit cakton numrin e bursave dhe shumën financiare për to".

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme të Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 26.04.2013 dhe zgjatë deri më 20.05.2013.

4. Shqyrimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: janar-mars 2013.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë, paraqiti vërejtje për hartuesin, pasi që nuk po jep komente nëpër faqe, sepse në anën e poshtme të tabelarëve duhet të ketë komente për secilën ngjarje që ka ndodhur brenda transaksioneve. Kurse sa i përket realizimit të të hyrave vetanake për këtë tremujor, shihet se ka një realizim afro 70 % të tyre apo 64 % sipas drejtorive, dhe shtoi se ky realizim i të hyrave nuk është në nivel të kënaqshëm, sidomos te disa drejtori, siç është Drejtoria për Inspektore, Drejtoria për Bujqësi, si dhe Drejtoria për Urbanizëm, prandaj ka qenë mirë që këto drejtori të angazhohen sa më shumë në mbledhjen dhe inkasimin e të hyrave vetanake, me qëllim të përmirësimit të gjendjes. Gjithashtu propozoi të bëhet rivlerësimi i ekonomive familjare dhe bizneseve, me qëllim të rritjes së të hyrave nga tatimi në pronë, duke shtuar se ka kërkuar disa herë në KPF që të ndodh kjo, kur dihet se ka një disbalancë të madhe në mes të rivlerësimit të parë (që është bërë para 12 viteve), po ashtu kur dihet se afro 2 milionë euro janë mjete të komunës që qëndrojnë të painkasuara e që këto mjete kishin ndikuar në rritjen e të hyrave vetanake dhe në përmirësimin e kushteve për qytetarët. Ndërsa te shpërndarja e të hyrave vetanake sipas kodeve, kërkoi sqarim nga drejtori në fjalë, kur thotë se te donacionet e brendshme dhe të jashtme ka një realizim 100 % krahasuar me planifikimin, kurse kur shikohet shfletimi i të hyrave vetanake sipas kodeve, shihet se donacionet e brendshme të planifikuara

kanë qenë 32.500 €, ndërsa realizimi është zero, që d.m.th se 0 % kanë qenë të realizuara. Por edhe te donacionet e jashtme, ku thuhet se 100 % janë planifikuar dhe realizuar, e në shfletim thuhet se 0 % janë planifikuar dhe realizuar. Sa i përket përbledhjes së shpenzimeve sipas burimit të financimit, pasi që është kuartali i parë, shihet se ka një shpenzim të ultë të këtyre mjeteve, por kërkoi që në të ardhmen të ketë specifikim për shpenzimin e këtyre mjeteve, sidomos te pozicioni i mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë, tha se e ndan të njëtin mendim me parafolësin. Po ashtu tha se informata duhet të ketë komente dhe sqarime, p.sh. pse ka rritje të të hyrave, si është arritur kjo, pse ka pas ngecje ose pse nuk është përbush plani, cilat kanë qenë pengesat? Pastaj tha se është përqindje e ultë te bujqësia dhe planifikimi urban, prandaj është e nevojshme që kryetari i komunës së bashku me drejtorin e financave dhe me drejtorët tjerë përkates të diskutojnë se ku qëndrojnë problemet dhe ku janë mungesat. Në vazhdim duke iu referuar Drejtorisë për Inspektime, tha se është një numër i madh i lokaleve që nuk i plotësojnë kushtet sanitaro-higjienike, dhe e njëjta gjendje e papastërtisë është edhe në mjetet e transportit publik, prandaj është detyrë e inspeksionit për t'i kontrolluar ata, dhe nëse nuk i plotësojnë kushtet, duhet t'ju merret leja.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se për informatën në fjalë është e nevojshme të ketë komente dhe arsyetime të një gjendjeje ekzistuese. Pastaj kërkoi informatë nga kryetari i komunës lidhur me gjendjen e 2 milionë eurove të mbeturat që janë të hyra të painkasuara, si dhe çfarë strukture e kemi, cilat janë firmat që janë më të mëdha, prandaj kërkoi një pasqyrim real. Gjithashtu tha se është e nevojshme të dihet specifikimi i shpenzimeve, sidomos për shërbime dhe mallra. Në fund tha se duhet të dihet se këto të hyra që janë paraqitur, a janë të gjitha të hyra të këtij viti raportues apo janë edhe nga vitet paraprake.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- duke iu referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me informatën në fjalë, paraqiti sqarime shtesë.

5. Shqyrtimi i Draft-strategjisë për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve (shqyrtimi i dytë).

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se Lëvizja për Bashkim e mbështet draft-strategjinë në fjalë.

Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit- e vlerësoi pozitivisht punën e ekipit që ka hartuar draft-strategjinë në fjalë dhe posaçërisht falënderoi përkrahjen e USAID-it në këtë drejtim. Në fund tha se edhe Grupi kuvendar i PDK-së e përkrah draft-strategjinë në fjalë.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- tha se Grupi kuvendar i LDK-së e përkrah draft-strategjinë në fjalë, duke uruar që sa më shpejt të fillojë zbatimi i saj.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se draft-strategjia në fjalë është një dokument i mirë. Pastaj tha se sugjerimet që janë dhënë kanë peshë për pushtetin aktual në prioritete, sidomos pikat gjatë vendosjes së kriterieve për ndarje të projekteve kapitale, të favorizohen ato lokacione që kanë paguar tatimin në pronë, prandaj Grupi kuvendar i AAK-së e përkrah draft-strategjinë në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanim vendosi me sa vijon:

Aprovohet Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve.

6. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Transparencë (shqyrtimi i dytë).

Selvete Sholla, anëtar e kuvendit- tha se Grupi kuvendar i LDK-së e përkrah draft-rregulloren në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për Transparencë.

7. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Dhënien e Dekoratave (shqyrtimi i parë).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së propozoi që te neni 4 të shtohet edhe çmimi për fermerët e vitit në Komunën e Vushtrrisë, dhe nëse futet ky çmim, atëherë edhe te neni 3 duhet të shtohet ky lloj i çmimit, dhe njëkohësisht pas nenit 9 duhet të hyjë çmimi për fermerin e vitit, si dhe duhet të cekën karakteristikat që duhet t'i përbajë një fermer për ta marrë çmimin e tillë. Pastaj te neni 10 propozoi që në termin "titull" dhe "çmim" të zëvendësohen me termin "mirënjojje".

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto vërejtje dhe propozime: te neni 2.3 propozoi që hiqet lidhëza "dhe"; te neni 5.2 propozoi që termi "të cilat" të zëvendësohet me "të cilët"; te neni 5.6 dhe te neni 6.5 tha se në aspektin protokollar në letër përcjellëse duhet të jetë edhe motivacioni për çka i ndahet.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi kuvendar i PDK-së e përkrah draft-rregulloren në fjalë, përvèç që mbështeti çmimin e propozuar nga I.Gashi, kërkoi që të inkorporohen edhe propozimet e paraqitura në KPF, siç janë: çmimi për biznese të suksesshme, pastaj për shëndetësi dhe për arsim.

Gjylsime Feka, anëtar e kuvendit- te neni 10 propozoi që emërtimi "penda e artë" të zëvendësohet me emërtimin "pena e artë".

Haki Maloku, përgjegjës i Sekretarisë- propozoi që në çdo rast në draft-rregullore ku përmendet termi "plaketë" të zëvendësohet me termin "pllakëz", dhe aty ku thuhet fletëmirënjojje, të thuhet fletëpërcjellje.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- propozoi që të përcaktohet numri i dhënies së dekoratave brenda një viti.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Dhënien e Dekoratave në Komunën e Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 26.04.2013 dhe zgjatë deri më 20.05.2013.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të LDK-së për anëtar të komisionit propozoi Xhemajl Pllanën.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të PDK-së për anëtar të komisionit propozoi Tasim Gubetinin.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit- nga shoqëria civile për anëtar të komisionit propozoi Isak Hysenin.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota "për", 6 "kundër" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim formohet komisioni për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale në këtë përbërje:

- 1. Habib Mustafa, kryesues i kuvendit të komunës (kryesues i komisionit);*
 - 2. Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit të komunës (zëvendës kryesues);*
 - 3. Tasim Gubetini, anëtar i kuvendit të komunës;*
 - 4. Tefik Maloku, agronom në Drejtorenë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim;*
 - 5. Ramiz Maliqi, zyrtar në Drejtorenë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;*
 - 6. Hyda Dallku, zyrtar në Drejtorenë për Prokurim Publik;*
 - 7. Isak Hyseni, përfaqësues i shoqërisë civile.*
- Mandati i komisionit është i njëjtë me mandatin e tanishëm të anëtarëve të kuvendit të komunës.*

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit mbi lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së- sqaroi se gjatë hartimit të propozim-vendimit ka rrjedh një gabim, ku në vend të 48.00.00 ha, duhet të jetë 24.22.00 ha. Në vazhdim paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se në bazë të praktikës së kaluar, në raste të tilla është kërkuar pëlgimi nga Ministria e Bujqësisë, kurse në rastin konkret nuk ekziston një pëlgim i tillë, dhe shtoi se thuhet që më parë ka qenë shtëpi e ndërtuar, por mund të ketë qenë shtëpi, mirëpo nuk ka pasur leje dhe prapë është e paligjshme.

Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së- lidhur me pyetjen e Xh. Pllanës, sqaroi se për kategorinë 5 e më lartë kompetent është kuvendi i komunës, kurse kategoritë prej 1-4 duhet paraprakisht ta marrin pëlgimin nga Ministria e Bujqësisë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se neni 2 është i tepërt, sepse kur të ndërrohet destinimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore, kushtet janë cekur në nenin 4, kurse kuvendi nuk merr vendim që të lejohet ndërtimi i objektit për afarizëm - banimor.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se pajtohet që kuvendi t'ju del në ndihmë qytetarëve, duke përfshirë edhe rastin konkret, por shprehu brengën e tij përfaktin që Komuna e Vushtrrisë po mbetet pa tokën e bukës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të përhershëm nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e cila është evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-70202028-00145, parcela kadastrale Nr.436/0, vendi i quajtur "arat mbi fshat" me kulturë arë e klasës së 5-të, në sipërfiqe prej 00.24.22 ha, Zona Kadastrale Stanoc i Poshtëm, pronë e Afrim Mehmetit nga Prishtina, rr. "Ibrahim Kelmendi".

Obligohet pronari i ngastrës nga neni 1 i këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të përhershëm të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 "a" të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, ku parashikohet 0.75 €/m² përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për përcaktimin e lartësisë së kompensimit përfaktit përfaktit përfaktit.

Haki Maloku, përgjegjës i Sekretarisë- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim përcaktohet lartësia e pagesës për Kryesuesin dhe anëtarët e Komitetit për Auditim të Komunës së Vushtrrisë për pjesëmarrje në mbledhjet e komitetit, si vijon:

Kryesuesi i Komitetit të Auditimit për pjesëmarrje në çdo mbledhje kompensohet nga 120.00 € (njëqind e njëzet euro);

Anëtarët e Komitetit të Auditimit për pjesëmarrje në çdo mbledhje kompensohen nga 100.00 € (njëqind euro).

11. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për mjekim për Liberta Ahmetin.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- lidhur me kërkesën në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të PDK-së propozoi që të ndahen 5.000 € nga subvencionet, dhe përveç këtij propozimi, secili anëtar i Grupit kuvendar i PDK-së do t'i ndajë nga 50 € për rastin në fjalë.

Pajazit Plana, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të LDK-së, tha se në parim pajtohem që të përkrahet kërkesa në fjalë, por paraqiti vërejtje profesionale, pasi që kërkesa e Liberta Ahmetit nuk figuron me propozimin e ordinaruesit që e ka dhënë se duhet të bëhet transplantimi i palcës ashtërore, sepse ai hematolog i cili e jep mendimin duhet të qëndrojë prapa saj dhe kuvendi i komunës duhet të votojë për të, sepse pa mendimin e hematologut palca nuk mund të ndërrrohet, dhe ndihma nuk mund të bëhet, prandaj kërkoi që të kompletohet lënda me mendimin e hematologut.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kërkesës në fjalë, tha se rasti është urgjent, prandaj duhet ndihmuar dhe nuk ka nevojë të shtyhet dhënia e ndihmës.

Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit- e mbështeti propozimin e shefit të Grupit kuvendar që për kërkesën në fjalë të ndahen 5.000 €, por përveç kësaj shume, propozoi që secili anëtar i kuvendit t'i ndajë nga 50 €.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se Grupi kuvendar i LDK-së pajtohet që për kërkesën në fjalë të ndahet shuma maksimale e lejuar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim z. Burim Ahmetit nga Vushtrria i ndahen mjete financiare nga buxheti i komunës- fondi për transfere dhe subvencione i Zyrës së Kuvendit (Grupi i Grave Deputete) në shumë prej 5.000 € (pesë mijë euro) ndihmë për shpenzime të mjekimit të vajzës së tij Liberta Ahmeti.

Pagesa e mjeteve duhet të bëhet pas ofrimit të dëshmisë me shkrim (dokumentacionit mjekësor) lidhur me diagnostifikimin e sëmundjes - caktimin e diagnozës së të lartpërmendurës.

12. Shqyrtimi i kërkesës së shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së për ndarjen e mjeteve përsigurimin fizik të objektit- zyrave të tyre.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se në bazë të informatave nga shoqatat e dala nga lufta janë thyer zyrat e shoqatave dhe të Kryqit të Kuq. Pastaj tha se procedurat e prokurimit për mbrojtjen fizike të objekteve komunale janë në zhvillim e sipër, prandaj kërkoi që edhe objekti (ku gjenden zyrat e shoqatave në fjalë) të gjejë vend aty.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- tha se e përkrahu që sa më shpejt që të jetë e mundur të bëhet sigurimi i objekteve dhe shtoi se së fundi është bërë një komision për stacionin e autobusëve, prandaj propozoi që dikush të angazhohet në sigurimin e objektit ku gjenden zyrat e shoqatave në fjalë, derisa të merret ndonjë vendim.

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsime- njoftoi se ka filluar sigurimi fizik i objektit ku gjendet stacioni i autobusëve, duke e mbuluar me punëtorët e shkollave. Kurse për objektin ku gjenden shoqatat e dala nga lufta, propozoi që të sigurohet një buxhet modest për të angazhuar një kompani për sigurimin e objekteve.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kërkesës në fjalë, tha se e mbështet kërkesën në fjalë, nëse aktet ligjore në fuqi e lejojnë komunën që ta merr përsipër sigurimin e objekteve, të cilat nuk i takojnë institucioneve komunale, dhe shtoi se është për t'u habitur që 13 vite pas luftës po dëmtohen zyrat e shoqatave të dala nga lufta.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- lidhur me kërkesën në fjalë, tha se le të mbetet në rishikim mundësia për përkrahje.

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit- tha se në vitin e kaluar në mbledhjen e KK-së të muajit shtator është marrë vendim për ndërtimin e një ure në fshatin Pantinë në lagjen "Kamberi", mirëpo në mungesë të mjeteve nuk është zbatuar ky vendim, prandaj kërkoi që herën tjetër me ridestinimin e mjeteve të ndërtohet ura në fjalë, pasi që në këtë vit ka pasur dy herë vërvshime, të cilat po shkaktojnë dëme të mëdha, por edhe nxënësve të kësaj lagje iu pamundësohet shkuarja në shkollë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- propozoi që të destinohen mjete për shtrimin e rrugës (nga përroi deri te familja Ferati, e cila është një familje e dëshmorit), dhe shtoi se e njëjtë rrugë ka qenë e propozuar edhe më herët, por nuk i di arsyet pse nuk është përfshire.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- në emër të Grupi kuvendar të LDK-së kërkoi që propozim-vendimi në fjalë të kthehet prapa, pasi që i njëjti nuk e ka nënshkrimin e propozuesit (kryetarit të komunës), prandaj si i tillë nuk është valid dhe nuk mund të procedohet.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 15 vota "për", 6 "kundër" të tjerët "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ridestinohen mjete nga fondi 10, nga kategoria e investimeve kapitale (programi 664250, Planifikimi Urban dhe Mjedis) nga ky projekt:

Asfaltimi i rrugës në fshatin Sfaraçak në vlerë 60,000.00 € (gjashtëdhjetë mijë euro), shuma e mjeteve të lira buxhetore 4,169.70 (kodi i projektit 88534), nga ky projekt ridestinohet në këto projekte që janë në realizim.

Nga projekt i cekur në nenin I të këtij vendimi ridestinohen mjete në shumën prej 4,196.70 € në të njëjtin program buxhetor, në këto projekte:

Projekti: Asfaltimi i rrugëve lokale në fsh. Mihaliq-lagjja "Mustafa", kodi 88509, shuma prej 944.00 €;

Projekti: Asfaltimi i rrugëve lokale në fsh. Bivolak, kodi 88508, shuma prej 2,230.50 €;

Projekti: Asfaltimi i rrugës në fsh. Reznik-Shalë, kodi 84386, shuma prej 995.20 €.

14. Të ndryshme.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- kërkoi nga qeveria komunale që të gjendet mundësia që të rregullohet çështja e problemit të hidrantit në fshatin Dobërrlukë, sepse me dhjetëra hektarë kanë mbetur pa ujitur për shkak të faktorit njeri dhe pengesave që po paraqet një banor i fshatit, toka e qytetarëve tanë po mbetet pa ujitur. Pastaj tha se është një pakënaqësi e qytetarëve të fshatit Bivolak për shkak të

punësimit, pasi që në Ibër-Lepenc po bëhen punësime nga komunat tjera, prandaj kërkoi që të mos vazhdohet me punësime të tilla nga komunat tjera, duke anashkaluar punësimet e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, dhe kërkoi përgjigje me shkrim për të dyja çështjet e ngritura.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- pyeti se a ka pasur kontakte kryetari i komunës me përfaqësuesit e Komisionit Evropian në lidhje me tejkalimin e problemeve që janë shfaqur sa i përket ndërtimit të objektit të komunës. Mandej tha se nuk është e vendosur një tabelë që tregon në lidhje me projektin që po realizohet në rr. "Dëshmorët e Kombit", se kur kanë filluar punimet në këtë segment dhe kur pritet të përfundojnë, prandaj pyeti se a ka pasur biseda kryetari i komunës me banorët dhe bizneset e atij segmenti të rrugës për t'i njoftuar për fillimin dhe për kohën e përfundimit të këtyre punimeve. Po ashtu pyeti se a ka menduar kryetari i komunës që të bëjë ndonjë lehtësim për këto biznese që operojnë në këtë segment të rrugës, pasi që ata për momentin dëmtohen.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- përmendi çështjen e furnizimit me ujë pasi që është një problem serioz, prandaj është e nevojshme që të dihet se çka po ndodh me fabrikën e ujit dhe kur pritet të përfundojë ndërtimi i saj, ndërkaq kërkoi informatë se cilat masa po ndërmerr përfurnizimin me ujë.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- pasi që ky muaj është i higjienës, pyeti drejtorin e DSHP-së se çka ka ndërmarrë për të eliminuar deponitë ilegale të mbeturinave, si dhe kërkoi të organizohet pastrimi i ambientit në qytet, dhe shtoi se në disa pjesë afër shkollës "Andon Zako Çajupi" gati gjysmë hektari është i mbuluar me mbeturina, por ka edhe pjesë të tjera të qytetit ku ka deponi.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- kërkoi që përbledhjen e ardhshme të KK-së qeveria komunale ta përgatit një plan operativ, i përcaktuar në kohë dhe me përgjegjësi, për eliminimin e mbeturinave dhe përpastërtinë e qytetit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

Procesmbajtësi:


Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit:

